



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 111/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Mitrovicë, për shkak të mbulimit të posterave në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 04.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Mitrovicë.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.06.2014, nga subjekti politik AKR dega në Mitrovicë, me të cilën pretendohet se më datë 30.05.2014, rreth orës 22:12, në rrugën “Mbretëresha Teutë” afër fotokopjes “Miri” dy persona kanë mbuluar posterin e presidentit të AKR-së duke e vendosur mbi të posterin e kandidatit për deputet të Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i, që ankesa e tyre të merret në konsiderat. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat nga Bekim Beka sipas së cilës theksohet se, me datë 30.05.2014, në ora 22:12 në afërsi të komunës pra afër fotokopjes “Miri”, i kamë parë dy persona duke e mbuluar banerin e AKR-së, i njejtë është ndëruar nga AKR me një baren të kandidatit për deputet të Kuvendit të Kosovës. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur 4 (katër) fotografi dhe leje njoftimin e dëshmitarit Bekim Beka si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

Nga pretendimet ankimore të cekura theksohet se me datë 30.05.2014 rreth orës 22:12 në rrugën “Mbretëresha Teutë” afër fotokopjes “Miri” dy persona kanë mbuluar posterin e presidentit të AKR-së duke e vendosur mbi të posterin e kandidatit për deputet të Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së. Mirëpo nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, shihet qartë se nuk është kryer ndonjë veprim i ndaluar dhe një pretendim i tillë është i

përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante, prandaj PZAP-i, konstatoi se ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 111/2014 më datën 04.06.2014

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*